



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË
KOMISIONI I EKONOMISË DHE FINANCAVE

Nr 1079 / Prot.
24

Divjakë më 20 / 02 / 2025

R A P O R T

Mbi shqyrtimin e Projektvendimeve të paraqitura nga Bashkia për mbledhjen e Muajit Shkurt 2025, e cila do të zhvillohet më datë 24.02.2025 ora 10.00.

Të nderuar Këshilltarë!

Mbështetur në nenin 17, pikat 1,2,3 të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Nenit 33, "Funksionimi i Komisioneve të përhershme" në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Divjakë;

-Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave u mbledh më datë 20 / 02 / 2025, pasi shqyrtoi Projektvendimet e paraqitur nga Bashkia;

VENDOSI:

1. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Janar 2025.
2. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Mbi akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Dhimitër Gorreja.
3. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Mbi akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Ibrahim Çobo.
4. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Për një saktësim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Divjakë, Nr. 58 datë 25.11.2024 "Për miratimin e "Paketës fiskale për sistemin e taksave e tarifave vendore, dhe penalitete për kundravajtjet administrative për vitin 2025", Bashkia Divjakë.
5. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Për miratimin e bashkëfinancimit për "Projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese, për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara, për vitin 2025".
6. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Për miratimin e një shtese në buxhetin e vitit 2025 nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2024.
7. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera në shkollat publike, të Bashkisë Divjakë.
8. Të kalojë për miratim: **Projekt-vendimin** - Për miratimin e "Planit të Integritetit 2025-2027, për Bashkinë Divjakë.

Shënim: Projektvendimet u votuan nga komisioni me 4 vota pro asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

KOMISIONI I EKONOMISË DHE FINANCAVE

1. Liri Biti (Kryetar)

2. Astrit Dervishi (zv/Kryetar)

3. Gojart Agolli (sekretar)

4. Fatjona Budani (anëtar)

5. Jurgen Shuli (anëtar)

6. Sahit Ibrahimaj (anëtar)

7. Adelajda Çuli (anëtar)

